



● RAPORTI për Konferencën e Parë Ndërkombëtare Modeli i Bashkimit Evropian Kosova 2016

Model European Union Kosovo 2016



"We chat to ideas"

Mars, 2016

Pohim:

Ky projekt është financuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit e Republikës së Kosovës dhe është mbështetur nga Parlamenti i Republikës së Kosovës, Ndërsa është implemetuar nga Instituti Cilësor për Hulumtime, Analiza dhe Trajnime iCHAT, asistuar nga ICCTW. Opinionet, gjetjet dhe përfundimet apo rekomandimet e shprehura këtu janë të Institutit Cilësor për Hulumtime, Analiza dhe Trajnime dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të mbështetësve .

© Të gjitha të drejtat të rezervuara nga Instituti Cilësor për Hulumtime, Analiza dhe Trajnime. Të drejtat për pronësi intelektuale mbrohen me Ligjin për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta 2011/04-L-065.

Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të ruajtjes, ose të transmetohet në ndonjë formë apo me ndonjë mjet elektronik, mekanik ose ndryshe, pa lejen paraprake të botuesit.

PËRMBAJTJA

Skurtesat.....	05
Hyrje.....	07
1. Rreth iCHAT.....	08
1.1. Misioni i iCHAT.....	08
2. Qëllimi i projektit.....	09
2.1.Rezultatet e pritura.....	09
3.Hapja joformale e Konferencës MEU Kosova 2016.....	09
3.1.Vizitë munumenteve kulturo-historike ne kryeqytetin e Republikës së Kosovës.....	10
4. Hapja solemne e Konferencës MEU Kosova 2016.....	13
5. Komitetet punuese të ndarë në gjashtë grupe.....	17
5.1.Plotësim ndryshimi i draft rezolutave nga Komisioni Evropian.....	21
5.2.Draft rezoluta për “Liberalizimin e vizave për Republikën e Kosovës.....	22
5.3.Draft rezoluta për “Rolin e shteteve të BE-së gjatë krizës së refugjatëve.....	23
6. Mbledhja e Këshillit të Ministrave.....	25
6.1.Qëndrimet e shteteve të BE-së, për draft rezolutën “Liberalizimi i vizave për Kosovën”.....	26
6.2. Press-konferenca për medie nga iCHAT.....	31
6.3.Votimi i rezlutës për heqjen e vizave për Kosovën.....	32
6.4.Qëndrimet e shteteve të BE-së, për draft rezolutën e dytë “Roli i shteteve të BE-së në krizen e refugjatëve”.....	32
6.5 Votimi i rezlutës “Roli i shteteve të BE-së në krizen e regjuatëve”.....	33
7. Vizitë monumenteve të trashëgimisë kulturore në qytetin e Prizrenit.....	34
8. Dita e fundit e Konferencës.....	36
8.1.Prezentimi i rezolutës “Liberalizimi i vizave për Kosovën”, nga kryesuesja e “Këshillit të Ministrave”.....	40
8.2. Debat në Parlament.....	43
8.3.Votimi i draft rezolutës “Liberalizimi i vizave për Kosovën”.....	43
8.4. Ceremonia e certifikimit.....	45
8.5. Aktiviteti simbolik te Monumenti NEW BORN.....	45
8.6.Fundi i Konferencës.....	46

Shkurtesat:

iCHAT- Instituti Cilësor për Hulumtime, Analiza dhe Trajnime

MKRS- Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit

ICCTW – I Choose to Change the World

MEU – Model European Union

BE- Bashkimi Evropian

PE – Parlamenti Evropian

KMBE- Këshilli i Ministrave i Bashkimit Evropian

KE-Komisioni Evropian

DR- Departamenti i Rinisë

OJQ- Organizatë Joqeveritare

Përshëndetje miq,

Dëshiroj të falënderoj ata që mbështetën dhe mundësuan realizimin e Modelit të Bashkimit Evropian Kosova 2016: Ministrinë e Kulturës Rinisë dhe Sportit, Kuvendin e Republikës së Kosovës, mbështetjen nga ICCTW dhe të gjithë partnerët tjerë.

Kur u hodh hapi i parë drejt krijimit të asaj që sot njihet si Bashkimi Evropian. Ministri i Jashtëm i Francës, Robert Schuman lexoi për shtypin ndërkombëtar një deklaratë ku i bënte thirrje Francës, Gjermanisë dhe vendeve të tjera evropiane për të bashkuar prodhimet e tyre të thëngjillit dhe çelikut që do të ishte “themeli i parë konkret për një Federatë të ardhshme Evropiane” dhe duke shtruar kështu udhën e Bashkimit të sotëm Europian. Vendet të cilave u drejtohej thirrja kishin dalë të rrënuara materialisht dhe moralisht nga konfliktet me njëra tjetrën. Ajo që propozonte Schuman ishte krijimi i një institucioni evropian mbi kombëtar, i cili do të administronte industrinë e prodhimit të thëngjillit dhe çelikut, sektor i cili në atë kohë ishte baza e fuqisë ushtarake.

Këtë ditë ceremoniale e nderon edhe më shumë prezenca e përfaqësuesve të institucioneve dhe misionëve të rëndësishme në Kosovë.

Modeli i Bashkimit Evropian është ngjarje që dallohet për nga vlera edukative, përsosmëria akademike dhe profesionalizmi, që e kthen atë një nga simulimet më të suksesshme dhe prestigjioze në botë. Për më tepër, duke krijuar një atmosferë të vërtetë evropiane në një mjedis të pastër evropian, si një kontribues në qëllimin e integritetit evropian dhe në shfaqjen e identitetit evropian.

Simulimi i Bashkimit Evropian u mbajt për herë të parë në Kosovë, me fokus në dy tema të rëndësishme: Roli i Shteteve të Bashkimit Evropian në krizën e refugjatëve, dhe Levizja e lirë e qytetarëve të Kosovës. Sikur që pas një ndodhie e kuptojmë se nuk paska qenë krejt e rastësishme, as përzgjedhja e këtyre temave nuk ishte aq rastësi. Ne vetë ishim refugjatë para pak vitesh, e derisa ishim të tillë vendet e Evropës i hapën dyert për ne, lëviznim lirshëm mirëpo tani kur jemi të lirë, dhe këto vende na duhen për t’i shijuar, për t’u arsimuar, për t’i njohur, e jo për t’u strehuar, na’i kanë mbyllur dyert duke mos e mbështetur liberalizimin e vizave për Kosovën.

Modeli i Bashkimit Evropian ua dha rastin të rinjëve të ndërveprojnë, ta njohin më mirë njëri tjetrin, dhe të simulojnë procedurat legjislative të Bashkimit Evropian që është destinacioni dhe qëllimi i Kosovës.

Kjo ishte një mundësi e mirë për të rinjtë e Kosovës, që të krijojnë një përvojë evropiane, një mundësi për të sjellë frymën evropiane të zhvillimit të proceseve të rëndësishme që i kontribuojnë të mirës së përgjithshme dhe mirëqenies mes popujve që synojnë integrimin në familjen evropiane.

Besmir Kokollari

Drejtor Ekzekutiv në iCHAT

Themelues i MEU Kosova

HYRJE

Modeli i Bashkimit Evropian, gjithashtu i njohur si MEU është një konferencë simulimi ndërkombëtar, i procesit legjislativ të Bashkimit Evropian, e cila synon që të lidhë të rinjtë nga e gjithë Evropa për të mësuar në lidhje me funksionimin e brendshëm të BE-së dhe procedurave të saj legislative. Simulimi i parë i Bashkimit Evropian u zhvillua në vitin 2007 në Strasburg dhe arriti një sukses të madh me mbështetjen e Parlamentit Evropian dhe Komisionit Evropian. Modeli i Bashkimit Evropian sot organizohet në shumë vende të ndryshme të Bashkimit Evropian, si Belgjikë, Spanjë, Gjermania, Kroaci dhe shumë vende të tjera. Një model i tillë është organizuar për herë të parë në Kosovë nga Instituti Cilësor për Hulumtime Analiza dhe Trajnime (iCHAT).

Kjo Konferencë ka arritur të mbledhë rreth 18 0të rinjë nga vendi, rajoni dhe Evropa, në selitë e institucioneve në Kosovë. Pjesëmarrësit patën mundësinë të jenë pjesë e roleve të ndryshme duke filluar nga Komisioner të BE-së, Ministra të Këshillit të Bashkimit Evropian, anëtarë të Parlamentit e deri tek interpretë, gazetarë e lobistë.

Duke marrë parasysh, aktualitetin e vendit tonë, në rrugën Evropiane, konsiderojmë se ky projekt ka arritur të përmbushë dy qëllimet kryesore të tij, që ishin njohuri praktike për të mësuar se si funksionojnë procedurat legislative të institucioneve të BE-së, në kuadër të kësaj edhe roli ynë në vendimmarrje, si dhe qëllimi tjetër ishte lobimi që u bë nga pjesëmarrësit e kësaj konference në institucionet e Republikës së Kosovës, drejtuar Bashkimit Evropian për të reflektuar pozitivisht karshi Liberalizimit të vizave për Republikën e Kosovës.

1. Rreth iCHAT

Instituti Cilësor për Hulumtime, Analiza dhe Trajnime është organizatë jofitimprurëse, e cila u themelua më 13.11.2014 sipas Ligjit Nr. 04/L-57 për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare në Republikën e Kosovës, duke vepruar sipas Statutit dhe akteve tjera juridike.

Qëllimi kryesor i iCHATështë:

1. Hulumtimi dhe analizat e pavarura të politikave publike në lëmin e qeverisjes demokratike si dhe hulumtime dhe analiza të shëndosha profesionale me paanshmëri të plotë të çështjeve vendore, rajonale dhe ndërkombëtare.

2. Fuqizimi i rolit të minoriteteve në shoqëri (të drejta të pakicave)- që jetojnë në Kosovë, duke i përkrahur, duke i promovuar të drejtat e tyre të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës që të jenë qytetarë të barabartë në Kosovë dhe njëherit duke qenë zë i fuqishëm i tyre për mundësi të barabarta për gjithë komunitetet që jetojnë në Kosovë.

Për t'i përmbushur qëllimet e saj, organizata iCHAT do të ndërmarrë, por nuk do të kufizohet vetëm në këto lloje të aktiviteteve: Hulumtime dhe Analiza, Konsulenca, Fuqizimi i rolit të minoriteteve në shoqëri (të drejtat të pakicave) , Avokim dhe Lobim, Të Drejta të Njeriut, Organizimi i kurseve për edukim dhe trajnim.

1.1. Misioni i iCHAT

Instituti Cilësor për Hulumtime Analiza dhe Trajnime “iCHAT” është për të çuar më tej mirëqenien e qytetarëve të Kosovës përmes hulumtimeve empirike, analizave dhe trajnimeve, inicimin për informimin e mirë të politikave publike, ndërgjegjësimin, të bashkëpunimit rajonal dhe ndërkombëtar, të drejta të pakicave, avokimit dhe rrjeteve.

Të ofrojmë nxitje dhe veprimtari të vlefshme për krijimin e nismave dhe politikave efektive, ide dhe aksione konkrete për të mundësuar një reagim të integruar të shtetit, shoqërisë civile dhe komunitetit ndaj veprimeve negative dhe të atyre që nxisin për veprime të tilla. Objektivi është që ta adresojmë këtë veprim në mënyrë efektive dhe dinamike në katër fushat bazë të përballimit të problemit, në zbatimin e ligjit, parandalimin, trajtimin e zvogëlimin e dëmit dhe edukimin.

2. Qëllimi i projektit

Qëllimi i Projektit

Qëllimi i këtij projekti ishte të organizohet konferenca e parë ndërkombëtare Modeli i Bashkimit Evropian, gjithashtu i njohur si MEU për herë të parë në Kosovë. Modeli i Bashkimit Evropian është një konferencë simulimi ndërkombëtare, i proceseve legislative të Bashkimit Evropian.

Konferenca ka mbledhur rreth 180 të rinjë nga e gjithë Evropa në selitë e institucioneve në Kosovë. Pjesëmarrësit ndërkombëtar kanë përfituar nga kjo konferencë e cila u mundësoi njohjen e praktikave, interaktivitetin dhe shkëmbimin e përvojave me studentët kosovarë duke përfshirë edhe ambientin ku ata zhvillojnë aftësimin e tyre akademik dhe inkurajimin e përfshirjes së të rinjve në debatet ndërkombëtare. Qëllimi i këtij organizmi përfshinë edhe ndërveprimin e kulturave të ndryshme për tolerancën ndaj diversitetit si vlerë për integrim në Bashkimin Evropian.

Objektiva e projektit ishte:

1. Organizimi i Modelit të Bashkimit Evropian për herë të parë në Kosovë.

2.1. Rezultatet e pritura

Rezultatet që janë pritur të arrihen me këtë projekt ishin:

- Zhvillimi i Konferencës sipas Modelit të Bashkimit Evropian për herë të parë në Kosovë;
- Promovimi i kulturës demokratike të organizimit të eventeve me karakter ndërkombëtar në Kosovë;
- Ndërveprimi i kulturave të ndryshme për tolerancën ndaj diversitetit si vlerë për integrim në Bashkimin Evropian.
- Njohuri praktike mbi mënyrën e funksionimit të proceseve legislative të institucioneve kryesore të BE-së.

3. Hapja joformale e Konferencës MEU Kosova 2016

iCHAT kishte bërë të gjitha përgatitjet për këtë konferencë. Në ditën e arritjes së pjesëmarrësve, iCHAT kishte angazhuar staf, për ti pritur pjesëmarrësit që do të vinin nga ora 8:00 e mëngjesit

deri në orën 12:00, dhe për t'i shoqëruar ata deri në Hotel Begolli për akomodim, ku iCHAT kishte bërë rezervimin. Pastaj sipas agjendës së paraparë, është mbajtur takim joformal me të gjithë pjesëmarrësit e MEU Kosova 2016, në Qendrën Kulturore dhe Informative të Bashkimit Evropian, në Prishtinë. Hapjen joformale e bëri Valëza Mjeku nga iCHAT, me ç'rast iu shprehu mirëseardhje të gjithëve. Pastaj pjesëmarrësit i përshëndeti edhe Drejtori Ekzekutiv i iCHAT, z.Besmir Kokollari, njëherit themeluesi MEU Kosova 2016 dhe uroi që bashkarisht të punojmë për qëllimet e kësaj konference gjatë këtyre katër ditëve. Kjo hapje joformale u shoqërua me një koktej rasti, duke krijuar mundësi për njoftim me njëri tjetrin, poashtu pjesëmarrësve iu dhuruan materiale me informacione për Bashkësinë Evropiane dhe institucionet e saj nga Qendra Kulturore dhe Informative e BE-së, në Prishtinë.



Foto: Hapja joformale në EU Centre, Prishtinë

3.1. Vizitë monumenteve kulturo-historike në kryeqytetin e Republikës së Kosovës

Pas takimit joformal, pjesëmarrësit u shoqëruan për drekë, dhe menjëherë pas saj vazhduan me vizitë në disa nga vendet e Prishtinës.

Nën udhëheqjen e Valdon Bytyqit nga iCHAT, pjesëmarrësit u dërguan për vizitë tek Muzeu Etnologjik i Kosovës, ku aty u pritën edhe nga drejtuesit e Muzeut, të cilët prezantuan objekte dhe artefakte të rëndësishme për Trashëgiminë Kulturore të Kosovës.



Foto: Vizitë në Muzeun Etnologjik të Kosovës

Pas Muzeut, vizita vazhdoi tek Monumenti “ Heroinat”, i cili iu është kushtuar sakrificës dhe kontributit të gjithanshëm të gruas kosovare gjatë luftës së vitit 1998/1999, ide kjo e inicuar nga gratë deputete të Parlamentit të Republikës së Kosovës.



Foto: Vizitë tek objekti “Heroinat”.

Poashtu u vizitua edhe monumenti “NEW BORN”, dhe u njoftuan pjesëmarrësit për rëndësinë dhe simbolikën e tij.



Foto: Vizitë te monumenti “NEW BORN”.

Në mbrëmje iCHAT kishte organizuar një event social për pjesëmarrësit.

Këtu përfundojnë edhe aktivitetet e planifikuara për ditën 03 mars.

4. Hapja solemne e Konferencës MEU Kosova 2016

Hapja zyrtare e Konferencës Modeli i Bashkimit Evropian Kosova 2016, u bënë ora 10:00, nga sekretari në iCHAT, z. Arianit Jashari, i cili në emër të iCHAT, i përshëndeti përfaqësuesit e institucioneve të Republikës së Kosovës, ambasadorët, misionet diplomatike në Kosovë, mediet prezente dhe të gjithë pjesëmarrësit e kësaj Konference.

Ai vazhdoi duke thënë se: “Modeli i Bashkimit Evropian Kosova 2016, mundëson njohuri praktike se si merren vendimet në BE, dhe veçanërisht sqaron procedurën legjislative të institucioneve kryesore të Bashkimit Evropian, duke krijuar mundësi të mira për studentët që të kuptojnë më mirë sfidat me të cilat ballafaqohet BE-ja çdo ditë.

Ndër të tjera ai përmendi se kjo Konferencë ka arritur të mbledhë numër të konsiderueshëm pjesëmarrësish nga vendi, rajoni dhe Evropa, të cilët gjatë punimeve të konferencës do të simulojnë rolet e “Komisionerëve Evropian”, “Ministrave të Këshillit të Ministrave” të BE-së, “Eurodeputetëve”, “gazetarëve” dhe “lobistëve”.



Foto: Fjala hapëse e Konferencës nga sekretari në iCHAT z. Arianit Jashari

Pas kësaj hyrje, Sekretariakaloi fjalën Drejtorit Ekzekutiv të iCHAT, njëherit themeluesit të MEU Kosova 2016, z. Besmir Kokollari, i cili në pika të shkurtra përmendi qëllimet e realizimit të projektit. Ai theksoi se: “Modeli i Bashkimit Evropian është Konferencë simulimi ndërkombëtar, i proceseve legislative të Bashkimit Evropian, e cila synon të lidhë të rinjë nga e gjithëEvropa, për të mësuar në lidhje me funksionimin e brendshëm të BE-së”. Ndër të tjera ai sqaroi se “MEU Kosova 2016 organizohet për herë të parë në Kosovë, nga Instituti Cilësor për Hulumtime, Analiza dhe Trajnime iCHAT, asistuar nga “I Choose to Change the World”(ICCTW) , në mbështetje të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit në Republikën e Kosovës. MEU nuk është vetëm një projekt unik arsimor që u jep pjesëmarrësve të saj mundësinë për të zhvilluar aftësitë e tyre në debate, komunikim dhe ligjbërje në një mjedis vërtetë ndërkombëtar, ajo është gjithashtu një vend ku të rinjtë kuptojnë se sibëhen ndryshimet dhe cili është roli i tyre nëpërmirësimin e gjendjes në botë dhe mundësi për ndërveprim kulturash si vlerë e shtuar e diversitetit Evropian”.



Foto: Gjatë fjalimit të Drejtorit Ekzekutiv të iCHAT, z. Besmir Kokollari në hapjen solemne të Konferencës.

Një fjalë rasti iu dha Drejtorit të Departamentit të Rinisë, në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, në Republikën e Kosovës, njëherit si mbështetës i këtij projekti, z. Xhevat Bajrami, i cili foli “për mundësitë e barabarta të të rinjëve kosovarë dhe potencialin e tyre, për të qenë pjesë e ndryshimeve progresive si pjesë e Evropës së Bashkuar”.



Në këtë hapje solemne të kësaj Konferencë, pjesëmarrësve iu drejtua edhe Kryetarja e Komisionit Parlamentar për Integritet Evropian në Kuvendin e Republikës së Kosovës, znj. Teuta Sahatqija, e cila ndër të tjera theksoi se “rininë e pret punë e madhe dhe pikërisht ju jeni ata që do të bartni proceset e rëndësishme dhe duhet të jeni të përgatitur që atë punë voluminoze e cila e pret shtetin e ri të Kosovës, të jeni në gjendje ta kuptoni se si funksionon vet Parlamenti Evropian dhe lëvizja e lirë në Evropë. Jam shumë e bindur se ju do të jeni ata që me entuziazëm dhe frymën evropiane që keni do të bëheni vlerë e shtuar e shtetit tonë”.

Krejt në fund fjala iu dha Prof.Dr.Ass. Afrim Hoti, Kryesues i Bordit në iCHAT. Profesori iu referua dy qëllimeve kryesore të kësaj Konference, sipas tij “ njohja në praktikë e funksionimit të Bashkimit Evropian, respektivisht të institucioneve kryesore të saj është një mundësi e jashtëzakonshme për studentët pjesëmarrës të kësaj konference që të mësojnë ecurinë e procedurave legislative të BE-së, por në të njëjtën kohë, ju studentë nga vendi, rajoni dhe Evropa jeni lobues serioz për liberalizimin e vizave për qytetarët e Republikës së Kosovës”.



Foto: Panelistët pjesëmarrës të Konferencës

5. Komitetet punuese të ndarë në gjashtë grupe

Pas përmbylljes së hapjes solemne të kësaj konference, aplikantët kanë filluar punën për hartimin e dy draft rezolutave, të ndarë në 6 grupe, të cilët ishin të udhëhequr nga liderët, ku roli i tyre ishte t'i udhëzonin aplikantët për procedurat e krijimit të këtyre rezolutave:

1. Liberalizimi i vizave për Republikën e Kosovës, si dhe
2. Roli i shteteve të BE-së në krizën e refugjatëve.



Foto: Grupi i parë punues



Foto: Grupi i dytë punues

Punimet në grupe kanë qenë të shoqëruara me shumëllojshmëri idesh të bazuara nga njohuritë dhe proceset aktuale politike dhe eurointegruese, ide dhe debate të cilat kanë rezultuar me krijimin e rezolutave mbresëlënëse nga ana e grupeve punuese.



Foto: Grupi i tretë punues



Foto: Grupi i katërt punues

Në përfundim të punimeve për temën “Liberalizimii vizave për qytetarët e Republikës së Kosovës”, grupet punuese kanë përzgjedhur liderët përfaqësues dhe secili prej tyre kanë prezantuar rezolutat që kanë krijuar bashkarisht, para “Komisionit” dhe grupeve punuese, Prezantimi i rezolutave është shoqëruar me pyetje dhe debat nga gazetarët dhe pjesëmarrësit tjerë.



Foto: Grupi i pestë punues

Me përfundimin e temës së parë, pas një pauze, pjesëmarrësit ashtu të ndarë në grupe kanë filluar hartimin e draft rezolutës së dytë që ishte: “Roli i shteteve të BE-së në rizën e refugjatëve”. pas hartimit të saj e njehta procedurë e prezantimit ishte edhe për draft rezolutën e dytë, e shoqëruar me pyetje dhe debat interaktiv nga pjesëmarrësit.



Foto: Grupi i gjashtë punues

5.1. Plotësim ndryshimi i draft rezolutave nga “Komisioni Evropian”

Pasi grupet punuese i përfunduan dy draft rezolutat e përmendura, atëherë “Komisioni Evropian” ka analizuar të gjitha rezolutat e grupeve punuese (gjithsej 12 rezoluta), dhe pas shqyrtimit, plotsim/ndryshimit bëri draftimin final të tyre për ti dorëzuar në “Këshillin e Ministrave të Bashkimit Evropian”.



Foto: Komisioni gjatë shqyrtimit të draft rezolutave

“Komisioni Evropian”, arriti që të bëjë plotësim/ndryshimin e rezolutave të hartuara nga grupet punuese dhe përzgjedhi këto dy rezoluta:

5.2.TEMA A

Draft - rezolutë

Sponsorë: Komisioni Evropian

Nënshkrues: Komisioni

Tema: " Liberalizimi i vizave për Republikën e Kosovës "

Duke njohur raportin e fundit nga Komisioni për Parlamentin Evropian dhe Këshillin, ne respektojmë rekomandimet dhe përfundimin e tyre duke iu referuar draft-rezolutës më poshtë:

- 1. Duke pasur parasysh konkluzionet e Presidencës të Këshillit Evropian të Selanikut të 19 dhe 20 qershorit 2003, në lidhje me perspektivën e vendeve të Ballkanit Perëndimor për hyrje në Bashkimin Evropian, që synon në forcimin e mëtejshëm të marrëdhënieve të privileguara midis BE dhe Ballkanit Perëndimor,*
- 2. Të vetëdijshëm për faktin se Kosova është shteti i vetëm në Evropë që nuk e ka lirinë e lëvizjes,*
- 3. Duke marrë parasysh se Kosova është shteti më i ri në vitin e tetë të pavarësisë së saj, e njohur nga shumica e vendeve Shengen,*
- 4. Duke vënë në dukje me kënaqësi progresin e bërë në vitin 2015 në arritjen e marrëveshjeve në kuadër të procesit të normalizimit të marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë,*
- 5. Të vetëdijshëm për mungesën e kushteve të socializimit si pjesë e procesit të riintegritimit,*
- 6. Duke pasur parasysh karakteristikat e sigurisë së dokumenteve të udhëtimit personal, kartat e identitetit dhe dokumentet bazike janë të kënaqshme,*
- 7. Duke theksuar se qytetarët e Kosovës nuk janë të lejuar të udhëtojnë jashtë vendit për qëllime edukative, sportive dhe nevoja shëndetësore,*
- 8. Duke kujtuar më tej për përmirësim në fushën e menaxhimit të kufirit,*
- 9. Duke pasur parasysh rrezikun për pavarësinë e gjyqtarëve/prokurorëve, të cilët vazhdojnë të jenë në shënjestër në përpjekjet për të ndikuar në situata të investigimeve të vazhdueshme dhe procedura juridike;*

Më tej rekomandon për të përmbushur kërkesat e mbetura dhe për të tërhequr vëmendjen ndaj prioritetëve kyçe që Bashkimi Evropian ka kërkuar;

5.1 Kërkon më tej për të përmbushur kërkesat në fushën e ri-integritit, Fondi i Riintegritit duhet të paguhet plotësisht;

6.1 Fton më tej të përmbushen kërkesat në fushën e sigurisë së dokumenteve;

8.1 Të përmbushë kërkesat në fushën e menaxhimit të kufirit, Kosova duhet të ratifikojë marrëveshjet për përcaktimin e kufijve me fqinjët e tjerë;

9.1 Të respektohen në tërësi kërkesat në fushën e luftimit të krimit të organizuar, edhe të sigurojë mbrojtje në kuadër të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;

10. Thërret OJQ-të dhe institucionet për të bashkëpunuar më ngushtë për zgjidhjen e problemeve në bazë të parimeve të BE-së.

5.3.TEMA B

Draft - rezolutë

Sponsorë: Komisioni Evropian

Nënshkrues: Komisioni

Tema: " Roli i vendeve të BE-së gjatë krizës së refugjatëve "

Duke njohur raportin e fundit nga Komisioni për Parlamentin Evropian dhe Këshillin, ne respektojmë rekomandimet dhe përfundimin e tyre duke iu referuar draft-rezolutës më poshtë:

- 1. I alarmuar nga veprimet e disa shteteve anëtare kundër refugjatëve (kufizim për kalimin e kufijve përkatës), që është në shkelje të parimeve të BE-së,*
- 2. Të vetëdijshëm për rrjedhjen masive të refugjatëve të përqendruar në BE dhe një rëndësinë kyçe të veprimeve të Bashkimit Evropian, duke vepruar si një, në këtë rast, në bazë të vlerave të njerëzimit,*
- 3. Duke kuptuar përplasjen që ekziston brenda dhe përtej kufijve të Evropës midis "Qytetërimit Lindor Islamik " dhe " Qytetërimit Evropian të Krishterë " për sa i përket vlerave të ndryshme morale, fesë, dhe perceptimit të të drejtave të njeriut dhe politikës,*
- 4. Thellësisht të shqetësuar për mungesën e monitorimit të kufijve të jashtëm të BE-së,*
- 5. Duke kërkuar për shpërndarje të barabartë të refugjatëve për kokë banori;*

1.1 Kujton të gjitha shtetet anëtare për parimet mbi të cilat BE-ja është themeluar dhe bën thirrje për vazhdimin e mbrojtjes së këtyre parimeve dhe të mësojë qytetarët e BE-së në lidhje me problemet me të cilat refugjatët po përballen;

2.1 Kërkon nga të gjitha shtetet anëtare për të përcaktuar përparësitë e krizës së refugjatëve për shkak të ndikimit që ka në Bashkimin Evropian dhe në mbarë botën, mbi vlerat e njerëzimit;

2.2 Inkurajon të gjitha shtetet anëtare që të tregojnë solidaritet dhe të marrin përgjegjësi për të ndihmuar refugjatët dhe shtetet e tjera anëtare të BE në nevojë.

3.1 Bën thirrje për bashkëpunim më të ngushtë në mes të shteteve, institucioneve dhe OJQ-ve për të zgjidhur së bashku një nga problemet më të mëdha në ditët e sotme;

3.2 Rekomandon tej një marrëveshje me shtete tjera të Lindjes së Mesme dhe Aziatike për të pranuar disa nga refugjatët;

3.3 Të thyhen barrierat në mes të kulturave dhe traditave të ndryshme, me përpjekje të ndërmarra nga BE-ja në luftën kundër islamofobisë;

4.1 Nxiti forcimin e kufinjëve të jashtëm të BE-së për të shmangur çështjet e keqtrajtimit duke iu referuar refugjatëve;

5.1 Kërkon shpërndarjen e refugjatëve që tashmë janë në vendet evropiane karshi GDP-së së shteteve anëtare të BE-së, duke iu siguruar atyre një vend për të qëndruar, punë praktike dhe ndihmë sociale.

6. Mbledhja e “Këshillit të Ministrave”

Konferenca në ditën e dytë të punimeve të saj sipas agjendës kishte simulimin e “Këshillit të Ministrave të Bashkimit Evropian”, për të diskutuar për dy draft rezolutat e inicuar nga “Komisioni Evropian”.



Foto: Mbledhja e Këshillit

Përfaqësuesja e Holandës, njëherit kryesuese e “Këshillit të Ministave” në BE, znj. Gentiana Fana, i ftoi ministrat e vendeve anëtarë të BE-së, që t’i rishikojnë dy draft rezolutat e inicuar nga “Komisioni”, pastaj ua kaloi fjalën “Ministrave të Këshillit të Ministrave të Bashkimit Evropian”.



Foto: Shqyrtimi i dy draft rezolutave

6.1. Qëndrimet e “Ministrave të shteteve të BE-së”, për draft rezolutën “Liberalizimi i vizave për Kosovën” e inicuar nga “Komisioni Evropian”

Austria- Ministri i jashtëm i Austrisë ripërsëriti se qeveria austriake e përkrah Kosovën në procesin e Integritimit Evropian, ai tha se Kosova ka përmbushur shumë kritere të kërkuara nga BE-ja, ku vlen të përmendet dialogu politik me Serbinë për normalizim të marrëdhënieve dhe poashtu ka arritur të bëjë menaxhimin e kufijve me malin e Zi, pavarësisht këtyre, Kosova ende mbetet e izoluar, ku qytetarët e saj nuk mund të lëvizin lirshëm, andaj ju bëj thirrje të gjithë ministrave që ta votojnë rezolutën për Heqjen e vizave për Kosovën “.

Bullgaria- Përfaqësuesja e qeverisë bullgare tha se “Kosova ka bërë progres të madh, krahasuar me të kaluarën e saj, sigurisht se vendi ynë e ka mbështetur pavarësimin e Kosovës dhe ju bëjmë apel vendeve anëtare të BE-së që ende se kan njohur Pavarësinë e saj, ta bëjnë një gjë të tillë sa

më parë. Poashtu dua të deklaroj së bullgaria mbështet plotësisht liberalizimin e vizave për Kosovën”.

Qipro- Ministri i jashtëm i Qipros tha se : “kemi një lloj marreveshje, ajo e Selanikut që është mbajtur në vitin 2003, ku janë cekur mundësitë e integritetit të Ballkanit përfundimor në Evropë, poashtu kemi parasysh që Kosova është vendi i vetëm që nuk ka lirinë e lëvizjes, dhe në të njëjtën kohë po bënë progress në përmirësimin e marrëdhënieve me Serbinë, mirëpo mendojmë që Kosova nuk ka përmbushur të gjitha kriteret e nevojshme për të fituar liberalizimin e vizave”.

Republika Çeke: “Ne e njohim Pavarësinë e Republikës së Kosovës edhe sovranitetin e plot të Kosovës. Që nga viti 2004 ne jemi antarë të BE-së. Kosova është një vend i ri me perspektivë evropiane. Çekia ka përkrahur Kosovën dhe investimet brenda saj, gjithashtu theksojmë se duhet të ketë angazhim të madh në aspektin politik dhe luftën ndaj krimit të organizuar. Kosova pra ka perspektivë Evropiane dhe duhet të bëhet anëtare e familjes së madhe Evropiane”.

Danimarka –“ Ne jemi të lumtur më progresin që është arritur në Kosovë, poashtu inkurajojmë të gjitha vendet që se kanë njohur ende Kosovën si shtet ta bëjnë një gjë të tillë. Kosova ka arritur ti përmbushë kriteret e kërkuara nga Komisioni Evropian, dhe ende qytetarët e këtij vendi nuk lëvizin lirshëm, pra danimarka është e shqetësuar me pamundësinë e lëvizjes së qytetarëve të Kosovës, andaj kërkojmë heqjen e vizave për Kosovën”.

Estonia - “Ne dëshirojmë marrëdhënie të mira me vendet e Ballkanit Përfundimor, ne poashtu kemi ndihmuar Kosovën në misione të ndryshme, është e rëndësishme që marrëveshja mes Kosovës dhe Serbisë do të zbatohet dhe që të dyja palët kanë punuar për arritjen e saj. Estonia do t’a ndihmojë Kosovën në çështjet ekonomike, dhe mbështesim plotësisht Kosovën në rrugën e saj Evropiane”.

Finlanda-“Është thellësisht e shqetësuar në lidhje me mosliberalizimin e vizave për Kosovën, prandaj Finlanda është pro liberalizimit të vizave për Kosovën në BE, liria totale për të udhëtuar në çdo vend. Finlanda ka qenë dhe është mbështetëse e Kosovës”.

Franca- “Pozicioni i Francës për liberalizimin e vizave për Kosovën është PRO, para së gjithash Franca është një vend që mbështet Kosovën, nëse është bërë liberalizimi i vizave për Serbinë dhe

Malin e Zi, atëherë pse të mos bëhet edhe për Kosovën. Ne gjithashtu mendojmë se liria do të bëjë ndryshime, Franca mbështet liberalizimin e vizave për Kosovën”.

Gjermania - “23 nga 28 vendet që e kanë njohur Kosovën. Ne e dimë se liberalizimi i vizave është një problem i madh, ata (qytetarët e Kosovës) nuk kanë nevojë për këtë problem. Në procesin e përmbushjes së kriterëve, Kosova nuk po trajtohet barabartë me vendet tjera të Ballkanit. Kosovës duhet t’i ipet i njejti rast sikurse fqinjëve të saj. Gjermania mbështet fuqishëm Kosovën në këtë aspekt dhe ne kërkojmë nga vendet e tjera që ta mbështetesin Kosovën për lëvizje të lirë”.

Hungaria: “Ne si shtet anëtar i BE-së, mbështesim çdo shtet tjetër për lëvizje të lirë, ne poashtu mbështesim fuqishëm progresin që Kosova ka bërë në këtë drejtim”.

Greqia: “Ne nuk do të njohim pavarësinë e Kosovës në asnjë mënyrë, pra, Kosova nuk ka nevojë për një liberalizim të vizave, kur e themi këtë mbështetemi në faktin që Kosova ka problem serioze në përcaktimin e vijës kufitare me Malin e Zi, tutje me dialogun me Serbinë dhe pa fqinjësi të mirë dhe pa sabilitet politik dhe ekonomik besojmë fuqishëm që Kosova është larg përfitimit të liberalizmit të vizave”.

Irlanda: “Ne kemi luajtur rol të rëndësishëm në zhvillimin e Kosovës, BE duhet ta ndihmojë Kosovën në marrëdhëniet e saj me Serbinë, Irlanda ishte pjesë e Anglisë pa lëvizjen e lirë ashtu si Serbia dhe Kosova, ne do të vazhdojmë të mbështesim Kosovën”.

Italia: Italia është e vetëdijshme se Kosova është shteti më i ri dhe meriton të ketë liberalizmin e vizave, dhe se rinia e Kosovës është e interesuar në përvetësimin e njohurive edhe jashtë vendit të tyre, prandaj, lëvizjen e lirë e konsiderojmë si të rëndësishëm dhe të domosdoshëm për qytetarët e Kosovës”.

Belgjika: ” Ne do të mbështesim gjithmonë Kosovën në mënyrë të hapur, ajo meriton liberalizimin e vizave, dhe ekziston guximi për të kaluar kufijtë dhe t’i tregojnë botës që ata janë të zgjuar në çdo aspekt”.

Anglia: “Ne do t’iu themi shteteve tjera që ta njohin Kosovën, ky vend ka plotësuar të gjitha kriteret, ne fuqishëm përkrahim raportin e fundit dhe ne e dimë që Kosova duhet të marrë liberalizimin e vizave këtë vit. Ne thërrasim çdo delegatë të votoj për liberalizimin e vizave

të Kosovës për shkak të realitetit të ri, izolimit duhet t'i vij fundi, në vërtetë besojmë se duhet ta njohin Kosovën dhe të fillojnë me procesin e liberalizimit të vizave”.

Suedia:“ Siç e dim nga ditët e para ne kemi perkratur në të gjitha format Republikën e Kosovës, ajo ka kaluar në disa faza të vështira gjatë rrugës së saj për zhvillimin e institucioneve të saj, mendoj se bashkarisht duhet t'a perkratur sa i përket liberalizimit të vizave sepse e dim pse është krijuar vet Bashkimi Evropian që ne si të bashkuar t'i krijojmë mundësi diversiteteve në tokat tona, jam pro mendimit të perkratur Kosovën për liberalizimin e vizave”.

Spanja:“ Kosova ka bërë një përparim të madh por ka shumë më tepër qëduhet të bëhet. Ne vendosim për të mos mbështetur liberalizimin e vizave”.

Sllovenia: “ Kosova është në rrugën e saj për tu bërë pjesë e BE-së, Kosova ka nevojë për mbështetje nga vendet fqinje sikurse ne, ne përgëzojmë Kosovën për punën e tyre, njërit në Kosovë kanë shumë potencial për të punuar. Ne jemi këtu për të ndihmuar njërin-tjetrin dhe Kosova gjithmonë mund të mbështetet në perkratjen e Sllovenisë, ftoj të gjithë shtetet që ta votojnë rezolutën”.

Sllovakia: “Përgëzojmë Kosovën për progresin e arritur dhe e mbështesim plotësisht liberalizimin e vizave për Kosovën”.

Rumania:“ Mbështesim plotësisht liberalizimin e vizave për Ballkanin Përfundimor, kjo do të ishte zgjidhja më e mirë për Kosovën, në të njëjtën kohë ne mendojmë se Kosova ka plotësuar kriteret”.

Portugalia:“ E vlerëson si një hap historik pavarësinë e Kosovës si dhe ka përmbushur kriteret për liberalizimin e vizave, ajo fton Kosovën për një bashkëpunim, për investime në fushën e ekonomisë njëkohësisht ngritjen e potencialit konkurrent me atë Evropian. Poashtu ne bëjmë thirrje për të votuar pro liberalizimit të vizave”.

Polonia:“ Ne kërkojmë që të fillojë menjëherë procesi për liberalizimin e vizave për Kosovën”.

Malta:“ Ne jemi të lumtur t'a shohim shtetin e Kosovës duke lëvizur lirshëm, fuqishëm mbështesim Kosovën në rrugën e integritit të saj”.

Luksemburgu: “Askush nga ne nuk ka të drejtë të pengojë lëvizjen e lirë, Kosova është në rrugë të drejtë të zhvillimit të saj por ka punë për të bërë, t’i japim, mundësinë Kosovës për t’a gëzuar të drejtën e lëvizjes së lirë”.

Latvia: ”Ashtu sikurse dihet ne kemi njohur pavarësinë e Kosovës dhe mbështesim rrugëtimin e saj për liberalizimin e vizave”.

Lituania:“ Ne jemi pro liberalizimit të vizave për Kosovën”.

Pas përfundimeve të opinioneve të përfaqësuesve të shteteve anëtare të BE-së, kryesuesja e “Këshillit të Ministrave” hapi debatin për liberalizimin e vizave. Debati rrjedhi si vijon:

Gjermania: “Ne duam t’i rikujtojmë Spanjës se liberalizimi i vizave është një proces teknik dhe jo politik, Kosovarët nuk kanë të drejtë të lëvizin të lirë kështu që ne mendojmë se zgjidhja më e mire për stabilitetin ballkanik është pikërisht mundësia e lëvizjes së lirë të qytetarëve të Republikës së Kosovës”.

Greqia: “Ne ripërsërisim se nuk do t’a votojmë këtë rezolutë”.

Anglia:“ Unioni Evropian duhet të funksionojë si një tërësi, ne ua rikujtojmë Spanjës dhe Greqisë që BE-ja iu ka mbështetur në zgjidhjen e çështjeve. Ne besojmë se edhe nëqoftëse nuk do të votojnë pro, të paktën duhet të mbani qëndrim neutral.”

Lituania:“ Më lejoni që t’ia rikujtoj Greqisë që liberalizimi i vizave mund të bëhet edhe për shtetet që nuk janë anëtare të BE-së, pra Kosova është i vetmi vend që nuk e gëzon të drejtën e lëvizjes së lirë ashtu si fqinjët e saj.”

Danimarka:“ Liberalizimi i vizave për kosovarët do të ndikonte në reduktimin e numrit të personave që marrin rrugën drejt Sirisë dhe njëkohësisht do të pyesja Greqinë : Si ka mundësi që ende nuk e njihen Kosovën dhe në të njëjtën jeni të ulur në tryeza”.

Çekia:“ Ne rekomandojmë që heqja e paragjyqimeve do të hapte rrugë për bashkëpunime të ndryshme me focus të veçantë vende të reja të punës”.

Anglia: Ashtu siç e kam përmendur në fjalimin e fundit, liberalizimi i vizave nuk do të thotë e drejta për të punuar apo për të lënë por kjo do të thotë e drejta për të lëvizur të lirë dhe të ndjehen

pjesë e familjes së madhe. Ne kemi nevojë për t’iu treguar kosovarëve se çfarë është BE-ja, duke i kujtuar Danimarkës që Kosova ka filluar të zbatojë ligjin kundër njerëzve të cilët janë të bashkuar në ISIS, le të shohim se çfarë është BE-ja.”

Gjermania: “Kosova tashmë e ka miratur ligjin kundër përfshirjes të të rinjëve në luftëra jashtë vendit. Poashtu unë do të doja të përmend se rezultatet e migrimit janë nga pamundësia e lëvizjes së lire”.

Greqia: “Jemi në mënyrë të prerë kundër liberalizimit të vizave të Kosovës”.

Këtu përfundon edhe debati i ministrave për liberalizimin e vizave për Kosovën.

6.2. Press-konferenca për medie nga iCHAT

Gjatë pauzës Drejtori Ekzekutiv nga iCHAT, z. Besmir Kokollari, Koordinatorja Albanë Hoti si dhe përfaqësuesi i organizatës ICCTW, z. Erdrin Allkja, mbajtën një press konferencë . Në të cilën ata treguan për rolin e ministrave, gazetarëve dhe lobistëve në këtë proces.



Foto: Pres konferencë.

6.3. Votimi i rezlutës për heqjen e vizave për Kosovën

Mbledhja e Këshillit ka vazhduar me dyer të mbyllura për të votuar këtë rezolutë. Kryesuesja e “Këshillit të Ministrave” i ftoj anëtarët e “Këshillit” që të votojnë për këtë rezolutë.

Këshilli vendosi me shumicë të cilësuar pro rezolutës që i hap rrugë liberalizimit të vizave për qytetarët e Republikës së Kosovës, kundër votuan Qipro dhe Spanja, abstenuan Greqia dhe Sllovakia.

6.4. Qëndrimet e shteteve të BE-së, për draft rezolutëne dytë “Roli i shteteve të BE-së në krizen e refugjatëve” e inicuar nga “Komisioni Evropian”

Menjëherë pas votimit të rezolutës së parë “Këshilli” shqyrtoi draft-rezolutën që kishte të bënte me “Rolin e shteteve të BE-së në krizën e refugjatëve” dhe qëndrimet e shteteve ishin :

Bullgaria: “Ne jemi pjesë e BE-së për nëntë vjet dhe disa prej problematikave çonin në përplasje të kulturave mes shteteve”.

Finlanda: “Pajtohem me ministrin e Bullgarisë, cili është problemi në këtë rast: nëse je musliman nuk mund të kalosh dhe nëqoftëse je i krishter mund të kalosh, ju lutem ma sqaroni përse?”.

Gjermania: “Gjermania mirëpret refugjatët, ne kemi respekt për të drejtat e njeriut, dhe ne kemi nevojë për kontroll më të mirë për kufijtë, ne kemi marrë numrin më të madh të refugjatëve në Evropë”.

Danimarka: “Ne kemi përjetuar një problem të madh në këtë drejtim, unë nuk jam pro kësaj rezolute dhe nuk do të jem asnjëherë”.

Çekia: “Krizë më e madhe është numri i madh i refugjatëve, nëse ne nuk i pranojmë atëherë ne e thejmë moton tonë për të respektuar të drejtat e njeriut, disa shtete po mbyllin kufinj të vet gjë që është në kundërshtim me BE-në. Suedia e dimë se ka një numër të madh të refugjatëve, ne duhet t’i shperndajmë refugjatët, kundërshton Danimarkën pasi i duket e paligjshme t’i japim mundësi të integrohen në vendin tone”.

Belgjika: “Qeveria e Belgjikës mbyll kufinjtë për refugjatët, ne kemi komunitete të shumta myslimane dhe ato trajtohen të gjitha në mënyrë të barabartë”.

Anglia: “Kërkoj që të largohet pika 1, 3 dhe 5”.

Votimet: Pika 1,3 dhe 5 janë larguar nga rezoluta.

Greqia: “Ne nuk kemi më shumë kapacitete për të pranuar refugjatë të tjerë”.

Lituania: “Ne jemi të gatshëm që të presim dhe regjuatë të tjerë”.

Franca: Ne mund t’a zgjedhim këtë problem nëse ne punojmë të gjithë së bashku. Ne duam që të ballafaqohemi me këtë problem dhe jo të hyjmë në konflikt, gjithashtu unë dëshiroj t’ua rikujtoj vendeve të lindjes se nëse ato janë me të vërtetë pjesë Evropës ne duhet t’iu japim atyre të drejtën për të marrë azilin sepse unë besoj se kemi kapacitete për t’a bërë këtë. I ftoj ata të votojnë, Franca është e gatshme për të pranuar një numër të madh të refugjatëve”.

Gjermania: Dëshiron për të shtuar një pikë të re në rezolutë.

Votimi: Nuk u pranua shtimi i një pike të re.

Danimarka: “Nuk ka nevojë për të shtuar një pikë të re në rezolutë”.

Hungaria: “Ne jemi vendkalim për refugjatët, ata na kanë shkaktuar shumë problem sepse autoritet tona kishin për t’u marrë me ta kështu që ne mendojmë se duhet të iu japim atyre të drejtën për të hyrë në vendet e BE-së.”

Çekia: “Disa shtete po shikojnë vetëm interesin e tyre, ne kemi dy mundësi, të bashkpunojmë në aspektin kombëtar dhe e dyta që këta refugjatë t’i rikthejmë nga kanë ardhur dhe ti mbysim ose ti mbajmë në vendet tona deri të stabilizohet gjendja, dhe si mendoni ta bëni këtë nëse jo sipas GDP-së.

6.5. Votimi i rezolutës “Roli i shteteve të BE-së në krizën e regjuatëve”

Pas diskutimeve të shumta dhe një debati rreth kësaj rezolute, ajo u hodh në votim mirëpo kjo Rezolutë nuk kaloi.

Në fund të mbledhjes së Këshillit, është mbajtur një konferencë për medie në të cilën kryesuesja e “Këshillit të Ministrave të BE-së”, znjsh. Gentiana Fana, së bashku me Ministrin e punëve të jashtme të Danimarkës Philip Frey, atë të Francës Oussama Boussada, Ministrin e Jashtëm të Gjermanisë Endrit Dibrani, Ministrin e Latvisë Granit Geci, si dhe Ministrin e Anglisë z. Eugen Cakolli, kanë paraqitur punën e këshillit, me ç’rast janë shoqëruar me pyetje nga ana e gazetarëve.



Foto: Konferencë për medie nga “Këshilli i Ministrave të BE-së”

7. Vizitë monumenteve të trashëgimisë kulturore në qytetin e Prizrenit

Pas përfundimit të punimeve të Këshillit të Ministrave dhe pas drekës, iCHAT vazhdoi me agjenden e paraparë, që ishte vizita në Qytetin e bukur të Prizrenit, ku iu bë vizitë monumenteve të trashëgimisë kulturore dhe duke u njoftuar nga afër me tolerancën, kulturën dhe traditën e lashtë që përfaqëson ky qytet.



Foto: Vizita në Prizren.

Pjesëmarrësit u ndanë të impresionuar me diversitetin kulturor, fetar dhe multi-etnik që ka Prizreni.



Foto: Vizitë në "Lidhjen Shqiptare të Prizrenit".



Foto: Vizitë në Prizren.

8. Dita e fundit e Konferenës

Në ditën e fundit të kësaj konference e cila u mbajt në sallën qendrore plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, hapjen e bëri Drejtori Ekzekutiv nga iCHAT, themeluesi i MEU Kosova 2016, z. Besmir Kokollari, i cili pasi përshëndeti të gjithë mbështetësit dhe pjesëmarrësit e kësaj konferenca, tha: “Simulimi i Bashkimit Evropian është Konferencë që mbahet për herë të parë në Kosovë, me fokus në dy tema të rëndësishme.”

“Roli i Shteteve të Bashkimit Evropian në krizën e refugjatëve, dhe Levizja e lirë e qytetarëve të Republikës së Kosovës”, Sikur që pas një ndodhie e kuptojmë se nuk paska qenë krejt e rastësishme, as përzgjedhja e këtyre temave nuk ishte aq rastësi. Ne vetë ishim refugjatë para pak vitesh, e derisa ishim të tillë vendet e Evropës i hapën dyert për ne , lëviznim lirshëm , mirëpo tani kur jemi të lirë, dhe këto vende na duhen për t’i shijuar , për t’u arsimuar, për t’i njohur, e jo për t’u strehuar, na i kanë mbyllur dyert duke mos e mbështetur liberalizimin e vizave për Kosovën” tha z. Kokollari.



Qëllimi kryesor i kësaj konference, që mbledhi student nga rajoni dhe Evropa, ishte thirrja që iu bë institucioneve të BE-së për te reflektuar pozitivisht karshi liberalizimit të vizave për qytetarët e Republikës së Kosovës.

Pasi përfundoi fjalimin, Drejtori e ftoi “Presidentin e Parlamentit Evropian” z. Philip Frey dhe anëtarët tjerë të vazhdojnë me procedurat e seancës.

Kryeparlamentari Philip Frey, ftoi për fjalë rasti Drejtorin e Departamentit të Rinisë në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, njëherit mbështetës i MEU Kosova 2016 i cili ndër të tjera tha:



“Jam i lumtur që jam në mesin e të rinjëve nga vendi, rajoni dhe Evropa të cilët sot në Parlamentin e Republikës së Kosovës llojnë për liberalizimin e vizave për qytetarët e Kosovës”

Kryesuesi i seancës z. Philip Frey, për fjalë rasti e ftoi edhe zëvendësministrin e Integritetit Evropian Z.Ramadan Ilazi i cili përshëndeti pjesëmarrësit e kësaj konference dhe vazhdoi fjalimin si vijon:

“Më vjen mirë që sot në këtë vend të rëndësishëm për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, në një frymë evropiane, jeni mbledhur që të votoni rezolutën për liberalizimin e vizave për Kosovën, dhe e çmoj shumë këtë përpjekje tuajën drejtuar institucioneve të BE-së, në mënyrë që të heqen vizat për Kosovën”.



Kryesuesi i seancës e ftoi për fjalë rasti edhe Drejtoreshen ekzekutive të organizatës Shqiptaro-Gjermane “ICCTW”, znjsh. Flogerta Krypi, e cila ndër të tjera tha: “ne të gjithë ecim në të njejtën rrugë, por jo gjithmonë bëjmë hapat e njejtë. Ne këtu sot përfaqësojmë “Parlamentin Evropian”, ju sot simuloni “Eurodeputetët”, dhe ç’do i ri në Kosovë e Shqipëri mund ta ndryshoj vendin ku ne jetojmë, sepse nëse ne nuk punojmë për ta ndryshuar Kosovën dhe Shqipërinë, të tjerët s’do ta bëjnë këtë, ndryshimet fillojnë nga ne. Ne jemi Evropë, skemi nevojë të bëhemi pjesë e Evropës sepse ne jemi Evropë”.

Krejt në fund të fjalimeve, Konferencën e Modelit të Bashkimit Evropian në Kosovë e nderoi edhe raportuesja për Kosovën në Parlamentin Evropian Ulrike Lunacek, e cila përmes një video mesashi iu drejtua pjesëmarrësve, duke thënë: “Mirë se vini në Konferencën Modeli i Bashkimit Evropian në Kosovë. Jam e kënaqur se kjo po realizohet në Kosovë për herë të parë, me më shumë se 200 të rinjë nga e gjithë Evropa. Siç e dini, unë si raportuese e Kosovës në Prlamentin Evropian, me të vërtetë e vlerësoj shumë kur të rinjtë janë të interesuar se si funksionon Bashkimi Evropian. E di, se tani kemi probleme brenda Bashkimit Evropian, por principi i bashkëpunimit në vend të konfrontimit, I solidaritetit në vend që të jemi kundër njëri-tjetrit, kjo

është ende e vlefshme, dhe unë shpresoj se nga kjo conference, kjo është diqka që ju do ta gjeni, mësoni dhe do ta praktikoni në jetët tuaja, personale dhe profesionale.



Andaj, knaquni, argëtohuni, mësoni shumë dhe mbani gjallë rrugëndrejt së ardhmes Evropiane. Gjithë të mirat”.

8.1. Prezentimi i rezolutës “Liberalizimi i vizave për Kosovën”, nga kryesuesja e “Këshillit të Ministrave” në “Parlament”

Kryesuesi i Parlamentit, z. Philip Frey e shpalli seancën e hapur dhe e ftoi Presidenten e “Këshillit të Ministarve të Bashkimit Evropian”, znjsh. Gentiana Fana, që të paraqes draft rezolutën për “Liberalizimin e vizave për Republikën e Kosovës”.

Kryesuesja e “Këshillit të Ministrave të Bashkimit Evropian paraqiti rezoluten për Liberalizimin e vizave për qytetarët e Republikës së Kosovës:



Foto: Prezentimi i rezolutes nga Kryesuesja e "Këshillit të Ministrave" znjsh. Gentiana Fana.

TEMA A

Draft - rezolutë

Sponsorë: Komisioni Evropian

Nënshkrues: Komisioni

Tema: " Liberalizimi i vizave për Republikën e Kosovës "

Duke njohur raportin e fundit nga Komisioni për Parlamentin Evropian dhe Këshillin, ne respektojmë rekomandimet dhe përfundimin e tyre duke iu referuar draft-rezolutës më poshtë:

1. Duke pasur parasysh konkluzionet e Presidencës të Këshillit Evropian të Selanikut të 19 dhe 20 qershorit 2003, në lidhje me perspektivën e vendeve të Ballkanit Perëndimor për hyrje në Bashkimin Evropian, që synon në forcimin e mëtejshëm të marrëdhënieve të privileguara midis BE dhe Ballkanit Perëndimor,
2. Të vetëdijshëm për faktin se Kosova është shteti i vetëm në Evropë që nuk e ka lirinë e lëvizjes,
3. Duke marrë parasysh se Kosova është shteti më i ri në vitin e tetë të pavarësisë së saj, e njohur nga shumica e vendeve Shengen,

4. Duke vënë në dukje me kënaqësi progresin e bërë në vitin 2015 në arritjen e marrëveshjeve në kuadër të procesit të normalizimit të marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë,

5. Të vetëdijshëm për mungesën e kushteve të socializimit si pjesë e procesit të riintegritimit,

6. Duke pasur parasysh karakteristikat e sigurisë së dokumenteve të udhëtimit personal, kartat e identitetit dhe dokumentet bazike janë të kënaqshme,

7. Duke theksuar se qytetarët e Kosovës nuk janë të lejuar të udhëtojnë jashtë vendit për qëllime edukative, sportive dhe nevoja shëndetësore,

8. Duke kujtuar më tej për përmirësim në fushën e menaxhimit të kufirit,

9. Duke pasur parasysh rrezikun për pavarësinë e gjyqtarëve/prokurorëve, të cilët vazhdojnë të jenë në shënjestër në përpjekjet për të ndikuar në situata të investigimeve të vazhdueshme dhe procedura juridike;

Më tej rekomandon për të përmbushur kërkesat e mbetura dhe për të tërhequr vëmendjen ndaj prioritetëve kyçe që Bashkimi Evropian ka kërkuar;

5.1 Kërkon më tej për të përmbushur kërkesat në fushën e ri-integritimit, Fondi i Riintegritimit duhet të paguhet plotësisht;

6.1 Fton më tej të përmbushen kërkesat në fushën e sigurisë së dokumenteve;

8.1 Të përmbushë kërkesat në fushën e menaxhimit të kufirit, Kosova duhet të ratifikojë marrëveshjet për përcaktimin e kufijve me fqinjët e tjerë;

9.1 Të respektohen në tërësi kërkesat në fushën e luftimit të krimit të organizuar, edhe të sigurojë mbrojtje në kuadër të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;

10. Thërret OJQ-të dhe institucionet për të bashkëpunuar më ngushtë për zgjidhjen e problemeve në bazë të parimeve të BE-së.

Në fund të rezolutes, kryesuesja e “Këshillit të Ministrave” u bëri thirrje “Deputetëve të Parlamentit” që të votojnë PRO kësaj rezolute.

Pasi kryesuesja e “Këshillit” përfundoi me rezoluten, atëherë kryesuesi i seancës i ftoi deputetët që të paraqesin qëndrimet në lidhje me këtërezolutë.

8.2. Debat në Parlament

Deputeti i parë: Bënë thirrje të gjithë deputetëve të mos e votojnë këtë rezolutë.

Deputeti i dytë: Kosova ka përmbushur të gjitha kriteret e kërkuara për liberalizimin e vizave, dhe ne fuqishëm e mbështesim këtë rezolutë.

Deputeti i tretë: Unë mbështes fuqishëm këtë rezolutë, dhe të gjithë ata që janë kundër I ftoj që ta lexojnë edhe një herë.

Deputeti i katër: Përmend liberalizimin e vizave për qytetarët e Kosovës, si një mundësi, për të vizituar dhe studiuar në vendet Evropiane, pra lëvisjen e lirë si një e drejtë elementtare.

Deputeti i pestë: Kosova ka bërë progress në rrugën e saj Evropiane, dhe ska dyshim se asaj i duhet lëvizja e lirë në vendet e BE-së, andaj ju ftoj të gjithëve të votojmë pro kësaj rezolute.

Deputeti i gjashtë: Unë e mbështes pa rezervë këtë rezolutë, sepse kjo rezolutë ndihmon qytetarët e Kosovës për të lëvizur lirshëm, andaj ju ftoj të gjithë juve që ta votoni atë.

Deputeti i shtatë: Mendoj se kjo rezolutë është zgjidhja më e mirë për qytetarët e Kosovës, andaj ju ftoj ta votojmë atë.

Deputeti i tetë: Qytetarët e Kosovës meritojnë të levizin lirshëm, dhe besoj fuqishëm se këtë do tua mundësoj nga sot Parlamenti Evropian.

Deputeti i nëntë: Kosova i ka përmbushur kriteret e kërkuara, andaj ju bëj thirrje të gjithëve ta votojmë këtë rezolutë.

Deputeti i parë: Është kategorikisht kundër votimit të kësaj rezolute, dhe i fton edhe njëherë të gjithë deputetët të mos e votojnë këtë rezolutë.

8.3. Votimi i draft rezolutës “Liberalizimi i vizave për Kosovën”

Pas përfundimit të debatit, kryeparlamentari e shpallë të mbyllur debatin dhe i fton deputetët të përgatiten për votim.

Pas votimit me 89 vota pro, 1(një) kundër dhe asnjë abstenim, “Parlamenti Evropian” miratoi rezolutën për heqjen e vizave për qytetarët e Republikës së Kosovës.

8.4. Ceremonia e certifikimit

Pas kësaj, kryesuesi i ftoi deputetët për një pauzë pesë minuta, dhe menjëherë pas saj ftoi themeluesin e MEU Kosova 2016, z. Besmir Kokollari të bëjë shpërndarjen e certifikatave për pjesëmarrësit e Konferencës së Parë ndërkombëtarë Modeli i Bashkimit Evropian Kosova 2016.





Foto: Ndarja e certifikatave për pjesëmarrësit në MEU Kosova 2016

8.5. Aktiviteti simbolik tek Monumenti NEW BORN

Pas ceremonisë së certifikimit, kryesuesi i ftoi të gjithë të shkojmë tek monumenti i NEW BORN-it, për një aktivitet simbolik që është paraparë nga iCHAT, përmes realizimit të një video, për të treguar pamundësinë e lëvizjes së lirë të qytetarëve të Republikës së Kosovës, dhe përmes kësaj iu bë thirrje institucioneve të BE-së që të veprojnë pozitivisht karshi liberalizimit të vizave.



Foto: Aktivitet simbolik tek NEW BORN që tregon getoizimin e kosovarëve

8.6. Fundi i Konferencës

Me këtë aktivitet, përfundoi punimet Konferenca e parë Ndërkombëtare Modeli i Bashkimit Evropian Kosova 2016, e implementuar nga Instituti Cilësor për Hulumtime, Analiza dhe Trajnime iCHAT, nëbashkëpunim me “ I Choose to Change the World” ICCTW, dhe e mbështetur nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, në Republikën e Kosovës.



Foto: Pjesëmarrësit e MEU Kosova 2016, në Parlamentin e Republikës së Kosovës.

PERSONELI I ANGAZHUAR NË PROJEKT

Drejtor Ekzekutiv

Besmir Kokollari

besmirkokollari@ichat-rks.org

Koordinator e projektit

Albanë Hoti

albanahoti@ichat-rks.org

Sekretar

Arianit Jashari

arianitjashari@ichat-rks.org

Chair Leaders:Asistent të projektit

Alba Boshnjaku

Blerinë Hoti

Blendë Mjeku

Blerina Surdulli

Ervina Krasniqi

Rina Koleci

Financierë:

Filloreta Gajraku

Geron Smajlaj

Alvisa Hoxha

Ligjërues:

Aurora Popova

Valdon Bytyqi

BORDI i iCHAT

Kryesues i Bordit

Prof.Ass.Dr. AFRIM HOTI

afrimhoti@ichat-rks.org

Anëtar i bordit në iCHAT

Prof.Asc.Dr. NASER PAJAZITI

naserpajaziti@ichat-rks.org

Anëtar i bordit në iCHAT

Prof.mrsc. Kujtim BUZHALA

kujtimbuzhala@ichat-rks.org

Aurela Zenunaj

Anemona Kurshumliu

Arsim Mehmeti

Dorentina Halili

Fortesa Thaqi

Florent Gashi

Fatos Isufi

Gresa Geci

Hazer Shehu

Iliriana Bajrami

Taulant Boshnjaku

Valton Ismajli

Video/Gazetarë:

Roksana Salihu

Driton Gajraku



Instituti Cilësor për Hulumtime Analiza dhe Trajnime
Rr./St. "Tringë Smajli" Prishtinë, Republika e Kosovës / Republic of Kosovo;
Tel. /Cell.: +377 (0)44 659 662 & +386 (0)49 659 662; E-mail: info@ichat-rks.org
www.ichat-rks.org

"We chat to ideas"

